# DËSHMI ARKIVI

**A-394214**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Apeli zbardh vendimin, arsyet, pse u la në burg aktivistja turke anti-Erdogan |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/apeli-zbardh-vendimin-arsyet-pse-u-la-ne-burg-aktivistja-turke-anti-erdo-i584131` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 14:24:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 15:55:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 52923a6af0d68c9aa71d09d073eb206e2d23b78870c19d83d611ba72ca75e836 |
| TEKSTI | 5198a81bfc898ac3ec908628c4cf3506893a85483ef5d82b28964e2ad926a4b9 |
| PAMJA | 265120852b0720cab442c8bdb60bb8d14c758c05fc796d9ba2bc6ecd057b09a3 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 34a3e9a57757fa7c56e23db890e09d9721398e7527915a12bbcfa24feef1b650 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326 |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 46991200 |
| TRANSAKSIONI | 0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3 |
| IPFS | QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/34a3e9a57757fa7c56e23db890e09d9721398e7527915a12bbcfa24feef1b650`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Apeli zbardh vendimin, arsyet, pse u la në burg aktivistja turke anti-Erdogan

TemA
5 Shtator 2026, 17:55Kronika TEMA



Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka zbardhur arsyetimin e vendimit, mes të cilit la në paraburgim për qëllime ekstradimi shtetasen turke Julide Yazici. 32-vjeçarja, e njohur për aktivizimin publik kundër presidentit Recep Tayyip Erdogan, që prej disa vitesh kishte statusin e azilantes në Francë, u arrestua në Rinas më 5 gusht.

Ajo kërkohej nga drejtësia turke, ku ishte dënuar me 4 vjet e 2 muaj burg nga dy shkallë të gjyqësorit për "dhënie ndihme logjistike për organizatë terroriste" dhe "pjesëmarrje në organizatë terroriste". Në thelbin e arsyetimit të vendimit të Apelit ishte rreziku i largimit të 32-vjeçares, nëse lirohej nga paraburgimi.

Sipas Apelit, ekziston një rrezik real që e reja t'i shmanget ekstradimit. Referuar vendimit, Yazici rezulton të ketë pasur dijeni të plotë për procedimin penal ndaj saj në Turqi.

*"Nëse gjatë fazës së hetimit apo gjykimit rreziku lidhet me shmangien nga hetimi ose gjykimi, në rastin konkret rreziku aktual lidhet me shmangien nga procedura e ekstradimit dhe nga dorëzimi tek autoritetet e shtetit kërkues për ekzekutimin e dënimit",* arsyetonte gjykata.

Apeli theksonte në vendim se masa "arrest në shtëpi" e kërkuar nga mbrojtja nuk ishte e përshtatshme dhe nuk garantonte mbikëqyrje efektive.

Në Apel 32-vjeçarja pretendoi se në rast ekstradimi drejt Turqisë do të përballej me persekutim, diskriminim dhe trajtim të padrejtë për shkak të bindjeve politike të saj dhe pjesëmarrjes në protesta anti-qeveritare dhe se nuk kishte pasur dijeni mbi vendimin e fajësisë të gjykatës turke.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

## Shkaktuan dy zjarre në Durrës, 3 të dyshuar si piromanë në pranga!

12:35 Kronika / 1 koment

[Zjarri në Himarë, shoqërohet në komisariat një person, dyshohet se i vuri flakën zonës]

12:05 Kronika / 2 komente

[KLGJ e KLP i rritën pagën vetes, ministri Gogu: S'do ketë përplasje institucionesh, mosmarrëveshja zgjidhet në Kuvend me ligj]

11:25 Kronika / 4 komente

[Bilanci i 24 orëve: Ministria e Mbrojtjes: Janë regjistruar 39 vatra zjarri, 6 banesa të djegura në Himarë]

10:45 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.